



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.05.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 25 mars 2019, 17, 23 dhe 24 prill 2019.
2. Seancë dëgjimore për raportimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për veprimtarinë e vitit 2018

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Andi Permeti, Korab Lita, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Edlira Bode dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Damian Gjiknuri, Alket hyseni, Elda Hoti, Alban Zeneli, dhe Tom Doshi

Të ftuar :

Shkëlqim Ganaj - Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Flori Karaj - Inspektor në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Evgjeni Bashari - Inspektore e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Si pikë e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit për datat 25 mars 2019, 17, 23 dhe 24 prill 2019.

Si pikë e dytë e rendit të ditës është seanca dëgjimore për raportimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për veprimtarinë e vitit 2018.

Para se të fillojmë me çështjet e ditës, më lejoni t'ju uroj mirëseardhjen në Komisionin e Ligjeve zotit Andi Përmeti, deputetit më të ri të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues i Partisë Bindja Demokratike.

Zoti Përmeti, mirë se erdhët në komision! Punë të mbarë dhe me krahë të lehta!

Gjithashtu, dua të uroj zotin Lita për postin e nënkryetarit të Komisionit të Ligjeve! Dje, Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të grupit që përfaqëson zoti Lita, vendosi që zoti Korab Lita të jetë nënkryetar i Komisionit të Ligjeve, si përfaqësues i opozitës.

Urime dhe me krahë të lehta!

Suksese të gjithëve!

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Ka vërejtje për procesverbalet nga kolegët? Nuk ka.

Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të komisionit për datat 25 mars 2019, 17, 23 dhe 24 prill 2019.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Sot, në Komisionin e Ligjeve, në vazhdenë e ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, radhën për të raportuar në këtë seancë dëgjimore e ka inspektori i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive. Inspektori do të raportojë për veprimtarinë e institucionit që drejton për vitin 2018. Raporti i plotë u është vënë në dispozicion kolegëve të mi deputetë. Nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit ka një material të përmbledhur, që u është vënë në dispozicion deputetëve.

Sot kemi prezentë Kryeinspektorin, zotin Shkëlqim Ganaj, zotin Karaj, inspektor, dhe zonjën Evgjëni Bashari, inspektore.

Mirë se keni ardhur!

Zoti Ganaj, ju, në fakt, nuk e keni herën e parë që vini për të raportuar në Komisionin e Ligjeve. Do t'ju kërkoja të bëni një prezantim të shkurtër të veprimtarisë së institucionit që drejtoni për vitin 2018, që më pas kolegët të kenë mundësi të bëjnë pyetje dhe diskutime.

Fjala për ju.

Shkëlqim Ganaj – I nderuar kryetar i komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Raporti vjetor i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave është një pasqyrë e plotë e punës dhe aktiviteteve të inspektoratit, i problematikave, rezultateve të arritura në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, masave konkrete të marra në funksion të parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit, forcimit të shtetit ligjor, bashkëpunimit ndërinstitucional e ndërkombëtar, si dhe transparencës realizuar me median, shoqërinë civile, organizma ndërkombëtarë dhe institucionet homologe.

Inspektorati i Lartë në ushtrimin e kompetencave institucionale ka pasur në fokus të veçantë rekomandimet e dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë, në rezolutën për vitin 2018 në drejtim të ruajtjes, forcimit, pavarësisë dhe integritetit institucional, duke qenë kështu garant i paanshmërisë, transparencës dhe objektivitetit, si faktorë që ndikojnë në arritjen e rezultateve konkrete në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Gjatë vitit raportues vijuan të mbështesim procesin reformues të sistemit të drejtësisë, si një masë e domosdoshme dhe emergjente për të rikthyer besimin e publikut tek institucionet e këtij sistemi, si dhe për të garantuar konsolidimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës me pjesën më të madhe të kapaciteteve institucionale.

Në këtë drejtim, bashkëpunimi me organet e rivlerësimit kalimtar, me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit u konsolidua më tej me qëllim përmbushjen e detyrave funksionale në mënyrë sa më efektive brenda afateve të parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ligjore në fuqi, të lidhura me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në total për periudhën 2017-2018 u dorëzuan të përfunduara raportet për 473 subjekte të procesit të rivlerësimit.

Kemi përfunduar dokumentacionin e plotë, së bashku me raportet e rëndësishme për gjyqtarët e gjykatave të Apelit, Gjykatës së Apelit Administrativ, Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, për prokurorët e prokurorive të Apelit, Prokurorisë së Apelit të Krimeve të Rënda, ndihmësat, këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave Administrative.

Në të njëjtën kohë, Inspektorati i Lartë ka vijuar me zbatimin me korrektësi të tri ligjeve bazë, duke referuar pranë organit të prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor, strukturave të Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave 53 raste, duke aplikuar njëkohësisht edhe 112 masa administrative me gjobë ndaj zyrtarëve të nivelit të lartë.

Gjatë vitit raportues janë zhvilluar një sërë sesionesh trajnuese për rritjen e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse në kuadër të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave. Janë trajnuar gjithsej 352 nëpunës dhe 226 njësi përgjegjëse në total.

Institucioni ka vijuar aktivitetin duke pasur prioritet edhe rekomandimet drejtuar Republikës së Shqipërisë nga GRECO dhe Komisioni European në raportin i vitit 2018 për Shqipërinë me koordinimin dhe mbështetjen me burimet e nevojshme të së cilave u përmbushën të gjitha angazhimet e marra në kuadër të projekteve asistuese nga USAID-i, BE-ja, Këshilli i Europës, sidomos në drejtim të ngritjes së sistemit elektronik të deklarimit *online* të interesave private.

Ndjekja e një politike të hapur me qytetarët, median dhe shoqërinë civile ka qenë në fokus të punës së institucionit duke trajtuar brenda afateve ligjore kërkesat e paraqitura, si duke kryer publikimin e 10 mijë e 450 deklaratave të interesave private.

Dëshirojmë të ritheksojmë edhe një herë angazhimin në përmbushjen e sfidave për të ardhmen në drejtim të detyrimeve kushtetuese ligjore lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, forcimit të mëtejshëm të rolit institucional dhe kontrollin e deklarimit të interesave private, parandalimin e konfliktit të interesave, si dhe hetimin e rasteve të sinjalizimit dhe garantimin e mbrojtjes së sinjalizuesve.

Këto ishin pak a shumë të dhënat shkurtimisht. Të dhënat më të detajuara janë në raportin me të cilin jeni njohur tashmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ganaj!

Fjalën e ka relatori, zoti Fino, pastaj jemi të hapur për pyetjet dhe përgjigjet përkatëse.

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Që në fillim dua të them se raporti i paraqitur nga institucioni përkatës është një raport, që në pamje të parë duket sikur nuk ka shumë faqe (janë rreth 32 faqe), por, në fakt, problematikat janë të trajtuara saktë dhe drejt. Më duhet të them se ky raport është i detajuar dhe i ardhur në kohë. Ne kemi pasur kohë të mjaftueshme për të diskutuar rreth këtij raporti.

Të nderuar kolegë, sot mbi tryeza ju kam vënë një material ku bashkë me Drejtorinë e Monitorimit ju informojmë për të gjitha çështjet e trajtuara në këtë raport, apo edhe për disa problematika që kanë dalë gjatë monitorimit vjetor periodik, sidomos, rekomandimet për vitin 2019.

Duke dashur të mos rilexoj materialin që ka secili, në rastin konkret, është bërë një punë e saktë, sepse këto institucione i monitorojnë mbi bazën e rekomandimeve që japim ne në Kuvendin e Shqipërisë. Këtu kam rekomandimet e Kuvendit vitin e kaluar, në anën e majtë

janë rekomandimet e Kuvendit dhe në anën e djathtë janë të dhënat dhe statuset që janë realizuar ose jo. Sipas këtij materiali që unë kam këtu përpara, 6 rekomandimet që ne ju kemi lënë në vitin 2018 rezultojnë si për asnjë institucion tjetër të realizuara 100%. Nëse ju e doni këtë material shtesë, që e kam bërë me drejtorinë e Botimeve do t'ju vë në dispozicion.

Dua t'ju them, gjithashtu, që Inspektorati, nën përgjegjësinë e Inspektoratit të Përgjithshëm, administron deklarin e pasurisë të detyrimeve financiare, ushtron kontrolle të drejtpërdrejta, mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që mbartin detyrim ligjor. Ky është thelbi dhe qëllimi përse ne e kemi krijuar. Unë mendoj se ky Inspektorat ka përmbushur rezolutën për vlerësimin e punës së inspektoratit të Kontrollit të Pasurive për vitin 2017. Unë mendoj se ka përmbushur rekomandimet e progresraportit, të BE-së dhe instrumenteve ndërkombëtare, ku Shqipëria është shtet anëtar, si, për shembull, lufta kundër korrupsionit.

Nga ana tjetër, më lejoni të ndalem në dy çështje që kanë të bëjnë me rekomandimet 4 dhe 5 të Greko-s. Në rekomandimin 4 rekomandohet që përmbajtja e deklaratave të pasurisë të anëtarëve të parlamentit të bëhet publike në faqen zyrtare dhe në një kohë të duhur duke marrë parasysh respektimin e privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe personave lidhur me ata që janë subjekt i detyrimit të raportimit. Në fund të këtij rekomandimi, Greko, arrin në përfundimin se rekomandimi është zbatuar në mënyrë të kënaqshme.

Në rekomandimin 5 të Greko-s rekomandon që deklaratat e pasurisë të anëtarëve të parlamentit t'i nënshtrohen një kontrolli më të shpeshtë. Ju e dini që ne kemi vendosur të mos ketë më përzgjedhje për deputetët dhe këtë e kam edhe për publikun në kuadër të një debati që kam bërë para disa ditësh me disa eksponentë të opozitës. Ne e kemi vendosur me ligj që për anëtarët e parlamentit, për deputetët të ketë një kontroll të hollësishëm në çdo dy vjet. Pra, dosja e pasurisë së Bashkim Finos, për shembull, do të monitorohet, verifikohet, analizohet në çdo dy vjet. Nuk është më si më përpara me short. Kjo gjë është hequr, është vendosur nga rekomandimet e Greko-s dhe në ligjin tonë. Të gjithë deputetët pa përjashtim kanë të njëjtin sistem kontrolli të pasurisë.

Nga ana tjetër, është rritur bashkëpunimi ndërmjet Inspektoratit të Deklarimit të Pasurisë dhe institucioneve përkatëse shtetërore. Greko arrin në përfundimin që edhe rekomandimi 5 është zbatuar në mënyrë të kënaqshme nga institucioni përkatës.

Vlerësimi i performancës së institucionit nga këndvështrimi i shërbimit të monitorimit është pozitiv. Unë nuk po ndalem, sepse kryeinspektori i paraqiti këtu.

Ajo ku unë dua të ndalem është problematika për të cilën ne duam të kemi një qasje ende më të mirë. Ajo për të cilën këmbëngul është se raporti, pavarësisht të dhënave të

detajuara dhe krahasuese ndër vite, nuk përmban të dhëna specifike të ndara për kategorinë e zyrtarëve të referuar penalisht, pra sa janë deputetë, gjyqtarë, prokurorë, drejtues vendorë, këshilltarë ligjorë e të tjera. Në raport, në fakt, mungojnë të dhënat e detajuara për rastet e zyrtarëve të kallëzuar penalisht, si, për shembull, klasifikimi i veprave penale të ndara në çdo kategori zyrash. Në raport mungojnë të dhëna, që u korrespondojnë kontrolleve të plota, të cilat janë rezultat i këtyre kontrolleve me numrin e kontrolluar. Në raport, gjithashtu, nuk jepen të ndara masat administrative, sa subjekte janë gjobitur për shkelje të ligjit të konfliktit dhe sa për shkelje të ligjit për deklarimin e pasurisë.

Unë kam parashikuar, zoti kryetar, edhe rekomandimet e Shërbimit të Monitorimit për autoritetin e institucionit për vitin 2019, janë rreth 5 pika, jo këto që kanë kaluar, sepse janë realizuar 100%.

Unë do të doja të bëja disa pyetje lidhur me informacionin që jep ky institucion në Kuvendin e Shqipërisë.

Si është ecuria e kallëzimeve penale të dërguara në prokurori, sa jenë në proces, si edhe ato që janë të mbartura nga vitet e kaluara, nëse nuk përbëjnë sekret? Në raport nuk keni dhënë detaje të hollësishme për këtë gjë.

Në rezolutën e vjetshme të Kuvendit ju keni kërkuar një pikë të veçantë që ju të ndërmerri edhe ankimimet në gjykatë ose prokurori për vendimet e mosfillimit, pra ka një handicap të madh. Kur ju dërgoni një dosje në prokurori, shpeshherë, siç keni raportuar ju në vitet e kaluara, prokuroria apo gjykata nuk i kanë filluar çështjet. Për këtë unë mendoj se duhet t'ju informojnë edhe juve.

Së dyti, cilat janë pritshmëritë tuaja? Kjo ka të bëjë edhe me strukturën organizative tuajën, ka të bëjë edhe me buxhetin e shtetit. Për këtë vit përballimi i sfidave ligjore, ju kanë vendosur tashmë si një institucion mirëfilli parandalues dhe antikorrupsion. Dua t'ju kujtoj këtu edhe faktin se shumë shpejt ju përsëri do të keni mungesë kapacitetesh të stafit tuaj, të nivelit inspektorat i lartë 5 plus 2, të cilët do t'i atashoni për 2 vjet rresht pranë Ministrisë së Brendshme në kuadrin e zbatimit të ligjit për vetingun e policisë për vitin 2018, që do të thotë se 5 veta nga ju do të jenë pjesë përbërëse e vetingut në polici, por, në fakt, ata që ikin nga ky institucion ulin rendimentin e punës dhe cilësinë. Do të doja të dija si do ta organizoni punën?

Së treti, në raport theksoni nevojën për amendime të ligjit nr.60, që ne kemi kaluar në vitin 2016, për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Ju doni ta ndryshoni këtë ligj, por nuk jepni detaje të hollësishme ku konsistojnë amendamentet që ju doni të bëni. Ju lutem, na e sqaroni problematikën e evidentuar nga ana juaj se cilat shihen si të rëndësishme në amendimin e këtij ligji.

Së fundi, kjo është e rëndësishme për publikun dhe deputetët, që pastaj të mos kemi debate midis nesh se ky ka 1 milion euro, apo ky ka orën më të mirë ose makinën më të mirë, dhe madje do të gjej mundësinë ta them edhe në seancë, nga të dhënat e progresraportit theksohet se operacionalizimi i plotë i sistemit të deklaratave të pasurive *online* nuk mund të sigurohet para viti 2022. Si mendoni, a është një afat i arritshëm nga ana juaj? Po u realizua kjo, unë do të jem i qetë, në daç me Fatmir Xhafajn, në daç me Aurora Marën, sepse të gjitha do të jenë *online* dhe ne do të jemi në rregull me deputetët e të gjitha krahëve pozitivë- opozitivë.

Këto tri katër pyetje i bëra për sqarime për kolegët e mi, sepse e kam studiuar me kujdes raportin, por kërkoj disa gjëra më të detajuara. Këtë material që kam paraqitur do t'ju jap të gjithëve, sepse duke punuar të gjithë në të njëjtën mënyrë, si ne ashtu edhe institucionet e tjera, jo pse unë e kam bërë më mirë, ku në njërin krah të jenë pasqyruara të gjitha rekomandimet për vitin e kaluar për një institucion, çfarë është dhe nuk është realizuar në këtë mënyrë duket performanca dhe puna e mirë e çdo institucioni që miratohet me ligj dhe Kushtetutë.

Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti inspektor!

Ulsi Manja – Ju falënderoj zoti Fino, për këtë prezantim shterues të gjetjeve të raportit të veprimtarisë të Inspektorit të Lartë të Deklarimit të Pasurisë për vitin 2018.

Zoti Ganaj, do t'ju lutesha të na jepnit përgjigje për pyetjet që ju bëri zoti Fino dhe besoj se do të kenë pyetje edhe kolegët e tjerë, por edhe unë natyrisht kam pyetjet e mia.

Fillojmë me përgjigjet për pyetjet që ju bëri zoti Fino.

Shkëlqim Ganaj – Faleminderit!

Po e filloj nga pyetja e fundit, e cila kishte të bënte me afatin për deklarimin dhe sistemin *online* të publikimit të deklaratave dhe interesave private.

Në muajin prill kemi përfunduar pjesën teknike të sistemit të deklarimit *online* të deklaratave dhe të interesave private të pasurisë, ndërsa viti në vijim do të jetë viti i testimit të sistemit me projekte pilot, sepse është një gjë teknikisht e vështirë dhe jo e thjeshtë, pasi ky sistem është i ri për gjithë institucionin.

Pra, i gjithë viti në vijim do të jetë një vit testimesh dhe trajnimesh të autoriteteve përgjegjëse në gjithë Shqipërinë, pasi edhe subjektet duhet të njihen me këtë mënyrë të re të deklarimit. Në vitin 2020, maksimumi viti 2021, ky sistem do të jetë i përfunduar.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Po, patjetër.

Sa i takon ligjit për sinjalizuesit ka pasur një problem për shkak se njësitë përgjegjëse nuk i kanë dërguar raportet pranë nesh, sepse për këtë gjë nuk ka asnjë mekanizëm detyrues ose sanksione në mënyrë që ne t'i detyrojmë të na i sjellin raportet. Unë mendoj se kjo pjesë duhet riparë dhe nëse nuk i sjellin brenda afatit, që është periudha janar-mars e çdo viti, duhet të ketë mekanizma që t'i detyrojnë për të na i sjellë, pasi ndryshe...

(Ndërhyrja nga salla pa mikrofon)

Jemi duke e ndjekur ecurinë e kallëzimeve penale. Me ndryshimet e reja të paketës ligjore që janë bërë në sistemin e drejtësisë, të gjitha vendimet e prokurorisë kontrollohen nga gjykatat, gjithsesi ne jemi duke bërë pjesën tonë se si do të jetë ecuria dhe për të ushtruar të gjitha mjetet ligjore për ato raste ku shohim që ka devijime dhe shkelje të ligjit.

Përveç ngarkesës që kemi pasur me vetingun për gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve, pesë inspektorë të inspektoratit janë atashuar pranë komisioneve të posaçme për ligjin e rivlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave. Paraprakisht kemi marrë masat për zëvendësimin e tyre në mënyrë që të gjitha proceset të ecin dhe mungesa të mos ndihet dhe në ditët në vijim do të bëjmë një raport të detajuar për këtë punë së bashku me kërkesat përkatëse për shtimin e numrit të punonjësve në kuadër të kësaj situatë të re.

Këto ishin përgjigjet në lidhje me pyetjet e zotit Fino.

Faleminderit, zoti Fino.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ganaj!

E ka kërkuar fjalën për pyetje kolegu Xhemal Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, për pyetjen që unë doja të bëja sapo u dha përgjigje nga pyetjet që bëri zoti Fino. Megjithatë, duke shfrytëzuar prezencën edhe si anëtar i Komisionit të Sigurisë jam i interesuar për ligjin e vetingut në polici, i cili ka gati një vit, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar. Doja të dija nëse keni ndonjë informacion për ndonjë shifër konkrete se sa kanë kaluar apo thjesht janë atashuar pranë komisioneve dhe nuk ka fare veprim?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Ganaj.

Shkëlqim Ganaj – Në dijeninë time janë në fazat fillestare të marrjes së zyrave, të pajisjeve ndihmëse dhe besoj se do të fillojnë brenda javës tjetër...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Rekrutimi ka përfunduar. Ne ju kemi vënë në dispozicion të gjitha të dhënat që kemi nga viti 2003, për gjithë punonjësit e policisë që kanë subjekt i deklarimit të interesave private. Kaq është ajo që ne mund të bëjmë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Kam unë dy pyetje për ju, zoti Ganaj. Në fakt, kolegu Fino i preku pak çështjet, por në raportin e detajuar që ju keni sjellë në komision shoh se për vitin 2018 keni raportuar 112 zyrtarë që janë ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për refuzim deklarimi apo në rastet e mosdeklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit. Pyetja ime konsiston, në fakt, kjo është më shumë për opinionin publik, cili është rrethi i këtyre gjyqtarëve të ndëshkuar me gjobë?

Pyetja tjetër ka të bëjë me detyrat dhe përgjegjësitë që ju ngarkon ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, ligji nr. 60, i vitit 2016. Në raport thuhet se keni administruar dhe analizuar 404 raportime të dërguara nga njësitë përgjegjëse nga të cilat 157 i përkasin sektorit publik dhe 247 sektorit privat. Doja të dija, nëse ju i keni të dhënat, të çfarë natyre kanë qenë 404 raportimet që keni administruar nga njësitë përgjegjëse? Ku konsistojnë këto 404 raportime të dërguara pranë institucionit tuaj, të çfarë natyre kanë qenë problematikat dhe kërkesat që keni marrë sinjalizim nga këto njësi përgjegjëse?

Këto janë dy pyetjet që unë kam për inspektoratin.

Shkëlqim Ganaj – Për vitin 2018 janë aplikuar 112 masa administrative gjobë, të ndara proporcionalisht për të gjitha aspektet e punës sonë, qoftë për refuzimin dhe mosdeklarimin e interesave private, pjesa tjetër ka qenë për konfliktin e interesave dhe për ligjin për sinjalizimet një pjesë, por të gjitha kanë qenë në mënyrë të barabartë. Këto masa përfshijnë të gjithë nivelin e zyrtarëve pa përjashtim, për momentin nuk mund t’ju jap të saktë për secilën kategori, por nuk ka zyrtarë që të mos jetë i përfshirë në këtë numër.

Ulsi Manja – Zyrtarët e nivelit të të gjitha institucioneve.

Shkëlqim Ganaj – Po, të gjitha kanë.

Sa i takon ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Janë 166 njësi përgjegjëse në sektorin publik dhe 446 njësi përgjegjëse në sektorin privat, për të cilat ne i kemi raportet, sipas ligjit për vitin 2018. Nga 247 raportimet që janë bërë nga sektorin privat nuk ka asnjë rast sinjalizimi dhe kjo është një çështje që duhet parë në vijimësi, sepse po bëhet viti i dytë që nuk ka asnjë rast sinjalizimi nga sektori privat. Unë mendoj se këtu duhen parë shkaqet dhe pse është kjo situatë.

Nga 157 raporte vjetore të njësive përgjegjëse të autoriteteve publike ka vetëm 3 sinjalizime. E para nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, e dyta nga Instituti i Sigurimeve

Shoqërore dhe e treta nga Autoriteti Portual Durrës, të cilat janë trajtuar nga ana jonë brenda afatit dhe u është dhënë zgjidhja sipas problematikës që ka pasur. Inspektorati i Lartë, si njësi e jashtme sinjalizimi, ka trajtuar 16 raste, ku 3 kërkesa për mbrojtje kanë ardhur nga sektori publik.

Në përfundim, është njoftuar Kontrolli i Lartë i Shteti për auditim për ato raste ku ka pasur probleme me tenderë dhe abuzime me fondet publike. Gjithashtu, është njoftuar për ndjekje penale Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si dhe janë njoftuar titullarët e autoriteteve publike qendrore për marrjen e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës. Të 16 rastet që kemi marrë ne si njësi e jashtme janë trajtuar të plota dhe brenda afateve. 3 kërkesa për mbrojtje nga hakmarrja janë trajtuar në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative brenda të gjitha afateve ligjore.

Shqetësim mbetet ajo që ju thashë në fillim, sepse është viti i dytë që sektori privat nuk ka sinjalizuar asnjë rast.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ganaj!

Meqenëse mbaruam fazën e pyetjeve, a ka diskutime nga kolegët?

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam njohur me raportin e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve për veprimtarinë e vitit 2018 të bërë nga ILDKPKI-ja, si dhe dëgjova raportimin tuaj dhe shpjegimet e relatorit, zotit Fino. Duke e krahasuar raportimin e vitit 2018 me raportimin e një viti më parë, unë shikoj progres në të gjitha fushat. Ajo që më bën më shumë përshtypje, si një nga detyrimet e vendit tonë në kuadrin e procesit integruar, por edhe në kuadrin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare në fushën e kontrollit të pasurive, dhe një nga elementet, që parandalon dhe ndihmon në luftën kundër korrupsionit dhe përdorimit të aseteve të krimit të organizuar në ekonomi është edhe përmbushja e rekomandimeve të lëna nga GRECO. Këto rekomandime janë shumë të rëndësishme, të cilat do të doja t'i theksoja në këtë mbledhje.

Një nga rekomandimet ka të bëjë me faktin se përmban orientime dhe detyrime të shtetit shqiptar, që përmbajtja e deklaratave të pasurive të deputeteve të bëhen publike në një faqe zyrtare në kohën e duhur, duke marrë parasysh respektimin e privatësisë dhe sigurisë së deputetëve dhe personave të lidhur me ta, që janë subjekt i detyrimit për raportim. Sipas GRECO-s, ky rekomandim është zbatuar në mënyrë të kënaqshme dhe jo më kot unë po e cilësoj si argument. Unë dua t'u rikujtoj të gjithë kolegëve të këtij komisioni, por edhe publikut

që na ndjek, se me iniciativën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe të deputetëve të maxhorancës, në bashkëpunim me Inspektoratin, vitin e kaluar u ndërmorën disa ndryshime për sa i takon procesit të transparencës, raportimit të të dhënave që deklarojnë jo vetëm deputetët, por edhe të zgjedhurit në të gjitha nivelet, si dhe funksionarët e lartë publik. Kjo iniciativë është ndërmarrë në mënyrë që ky sistem transparence të mos publikojë vetëm të dhëna, të cilat do të raportohen, por të jetë i përfshirë në një sistem dixhital *online*.

Duke iu referuar edhe pyetjes që bëri relatori dhe përgjigjes që dha zoti Ganaj, kjo ka të bëjë pikërisht me sistemin *online*, për të cilin në progres-raportet e Shqipërisë për vitet e fundit ne kemi pasur komente të natyrës se sa më shumë të vonohet një sistem i tillë, aq më e ngadaltë do të ishte edhe përpjekja e Shqipërisë për të ecur përpara në kuadrin e transparencës. Prandaj, unë do të doja të jepja vlerësimin tim për shpejtësinë me të cilën u veprua, në mënyrë që ky sistem të jetë i aftë për të qenë efektiv brenda vitit 2021. Ndërkohë, sipas raportit, unë shikoj se ju keni filluar me testimin e të gjithë sistemit. Nëse gjatë këtij viti testimet do të rezultojnë të suksesshme, unë çmoj se ju do të arrini ta ngrini këtë sistem dhe do të bëhet efektiv brenda vitit 2021.

Nga ana tjetër, edhe rekomandimi i ri i GRECO-s, i cili ka të bëjë me faktin e rritjes së bashkëpunimit ndërmjet ILDKPKI-së dhe institucioneve përkatëse, por edhe private, është, gjithashtu, i përmbushur dhe i kënaqshëm – thotë GRECO, sepse në ndryshimet e fundit që iu bënë ligjit përkatës, me të cilin ju operoni, u parashikua edhe detyrimi i operatorëve në sistemin privat, siç janë bankat, për të dhënë të dhëna, edhe kur kërkohen nga përfaqësues të tjerë të institucionit, jo vetëm nga Inspektorati. Pra, gjithçka është një tregues i qartë i vullnetit dhe i përgjegjshmërisë për të ecur para në këtë fushë, në mënyrë që jo vetëm në kuadër të transparencës, por edhe në kuadër të veprimeve parandaluese, luftës kundër korrupsionit dhe aseteve kriminale në veprimtaritë korruptive të kemi ritme të kënaqshme për të përmbushur njëherazi jo vetëm detyrimet që ka Shqipëria në kuadër të integritetit në Bashkimin Europian, por edhe ato detyrime që të gjithë i kemi karshi shtetasve shqiptarë, karshi qytetarëve të vendit tonë, për të qenë më të përgjegjshëm në formimin e të gjithë elementeve të shtetit ligjor dhe në zbatimin e ligjit.

Unë ju falënderoj dhe shpresoj që në rekomandimet e vitit 2019 të vendosim edhe ato që janë nxjerrë të papërmbushura nga raporti ndërkombëtar, si dhe të realizojmë ndryshimet ligjore të nevojshme për sa i takon ligjit “Për konfliktin e interesave”, të cilat i kemi diskutuar në mbledhjet e organizuara me grupet e punës dhe po punohet ende.

Unë do të doja ta bëja të ditur për opinionin publik se një grup pune brenda Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues të Inspektoratit është duke punuar për

përmirësimin e legjislacionit në lidhje me konfliktin e interesit për ta bërë atë më të qartë, për ta përafëruar me standardet ndërkombëtare, në mënyrë që të mos ketë më asnjë ekuivok nga zbatueshmëria e ligjit për sa u takon përcaktimeve në ligj.

Kështu që ju falënderoj dhe ju uroj punë të mbarë!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

A ka diskutime të tjera nga kolegët?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Meqenëse nuk ka asnjë diskutim tjetër unë, si relator, në kuadrin e pyetjeve që u bënë dhe informacionit që u dha këtu, do të doja që kryeinspektori të jetë më i hapur në diskutimet që do të ketë në seancë plenare për të dhëna krahasuese ndër vite, por të jenë edhe të specifikuara. Kjo do të jetë një gjë e mirë për publikun dhe për deputetët.

Së dyti, me siguri do të bëjmë një mbledhje tjetër që të vihen në eficiencë edhe këto dy apo tri momente që kanë të bëjnë me ligjin e sinjalizuesve. Për këtë gjë kryeinspektori kërkoi ndihmë nga ne, sepse kërkon një ndryshim të ligjit, për shkak se ka dy vjet që është në fuqi dhe, me sa duket, nuk po gjen zbatim për të dhënë informacionet e nevojshme. Ne nuk mund të bëjmë thjesht ligje që të jemi në rregull me BE-në, ndërkohë që ato nuk janë të zbatueshme dhe nuk i shërbejnë një institucioni që është shumë i rëndësishëm, siç është ILDKPKI-ja, e cila nëpërmjet sinjalizimeve do të bëjë të mundur procedimin për drejtuesit, qofshin këta privatë apo shtetërorë. Unë mendoj se në rekomandim duhet të jetë edhe kjo si çështje për t'u zgjidhur.

Pyetja e detajuar që bëtë ju si kryetar që i ndatë gjobat private nga ato publike, njëkohësisht edhe sqarimet, të cilat janë më të sakta në raport, qoftë rekomandimet e GRECO-s, qoftë edhe progresraporti i vitit të kaluar apo edhe ai që presim të vijë, janë një ndihmë shumë e madhe që të paktën një institucion ta kemi konkret dhe korrekt, në mënyrë që të jetë i hapur për të gjithë shqiptarët, në radhë të parë, për ne deputetët për të qenë transparentë dhe korrektë, sepse, sa më i fortë dhe i mirë të jetë ky institucion, aq më mirë do të ecin punët.

Duket sikur në plan të parë ka një konflikt interesi ndërmjet nesh dhe jush, por absolutisht nuk është kështu. Në fund të fundit, ne thjesht u kërkojmë llogari, sepse të gjithë i kanë dosjet e tyre, në kuptimin e skedës pasurore, të cilat do të kontrollohen dhe do të monitorohen çdo dy vjet. Kjo tashmë është një gjë pozitive, sepse, njëkohësisht, Inspektorati bën hetime dhe në fund del me deklarata, të cilat bëhen publike për të gjithë shqiptarët. Ndaj, me të drejtë, unë dhe zonja Bushka kërkuam që në vitin 2022, pse jo një vit më parë, Inspektorati të ketë mundësi që deklaratimet e anëtarëve të parlamentit shqiptar të jenë *online*.

Unë, së bashku me Drejtorinë e Monitorimeve, kam përgatitur 5 pika, por të shtojmë edhe dy të tjera që të jenë në kuadër të rekomandimeve të vitit 2019. Rekomandimet e vitit 2018 janë plotësisht të realizuara dhe për këtë jam i kënaqur. Gjithashtu, besoj se edhe rekomandimet e vitit 2019 do të realizohen nga Inspektorati.

Si relator, javën tjetër do t'ju paraqes projektin me rekomandimet e këtij institucioni për vitin 2019, ku do të përfshihen edhe këto 2-3 gjërat që u trajtuan këtu, të cilat do të jenë më të detajuara edhe në rezolutën që do të miratojmë.

Faleminderit!

Ulsi Maja – Faleminderit, zoti Fino!

Unë dua ta mbyll edhe këtë pikë të fundit të rendit të ditës.

Si kryetar i komisionit dua të shpreh disa konsiderata në lidhje me punën e këtij institucioni, por edhe me gjetjet e raportit që ky institucion ka sjellë nga ana e relatorit dhe nga pyetjet e kolegëve të mi deputetë.

Inspektorati është një nga agjencitë më të rëndësishme shtetërore në luftën kundër korrupsionit në radhët e zyrtarëve të lartë. Unë e gjej me vend të përshëndes punën e mirë dhe përpjekjet e vazhdueshme të kësaj agjencie, si një kontribut me vlerë, në luftën kundër korrupsionit në radhët e zyrtarëve të lartë.

Më vjen mirë që janë përmbushur plotësisht rekomandimet e lëna me rezolutën e Kuvendit për vitin 2018. Këtu gjej rastin të falënderoj relatorin, kolegun Bashkim Fino, sepse mënyra e paraqitjes së përmbushjes së detyrimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit është një risi, pra forma e paraqitur nga relatori. Kjo formë na jep mundësi të njihemi më në detaje me plotësimin e detyrave të lëna nga Kuvendi për Inspektorin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, por edhe në rezolutën që do të miratojmë në mbledhjen pasardhëse ne do të kemi një panoramë të qartë të detyrave që janë përmbushur dhe të atyre që nuk janë përmbushur, të cilat do të duhet të lihen si detyra kryesore për vitin 2019.

Punën e mirë e këtij institucioni unë e shikoj në dy shtylla.

Së pari, në mbështetjen e vazhdueshme që Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi i Shqipërisë i ka dhënë këtij institucioni, por edhe në seriozitetin me të cilin ky institucion, ndonëse është i paktë në numër, ka përmbushur detyrat. Ky institucion jo vetëm që ka përmbushur detyrat që i ngarkon ligji organik “Për kontrollin dhe deklarimin e pasurive”, por edhe detyra të tjera shtesë, që janë lënë me ligjet e reja të reformës, këtu e kam fjalën për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, detyrat e ngarkuara me ligjin “Për vetingun në Policinë e Shtetit”, por edhe detyra të tjera që i ngarkon ligji nr. 60 i vitit 2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi i kanë përmbushur detyrat e veta në raport me këtë institucion, këtu kam parasysh ndryshimet ligjore që ne bëmë në ligjin organik në lidhje me deklarinimet *online*.

Zonja Bushka solli në vëmendjen e kolegëve bashkëpunimin e komisionit me Inspektoratin, të cilët po punojnë për ndryshimin e ligjit për konflikt interesit.

Zoti kryeinspektor, e shikoj me rëndësi që pjesë e këtyre ndryshimeve ligjore që ne kemi në proces me ligjin “Për konfliktin e interesit” të jenë edhe shqetësimet që ju ngritët për ligjin “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Pse e them këtë? Sepse ky ligj është në vitin e tretë të zbatimit dhe kemi 247 raporte nga njësitë përgjegjëse në sektorin privat dhe nuk ka asnjë rast, ndërsa nga njësitë përgjegjëse në sektorin publik kemi 157 raportime dhe ka vetëm tri raste. Pra, një ligj që në tërësinë e tij në 3 vjet zbatim është shumë larg qëllimit për të cilin u miratua. Kjo nuk do të thotë se nuk ka raste, sepse kemi 16 raste të deklaruara si njësi e jashtme dhe këto janë raste të ndërmarra nga Inspektori i Lartë i Deklarimit të Pasurive, nga të cilat 3 kanë qenë me kërkesë dhe 13 të tjerat kanë qenë si njësi e jashtme. Gjithashtu, kemi raste flagrante të raportuara në Kontrollin e Lartë të Shtetit, për të cilat është ndërmarrë një kontroll nga ana e këtij institucioni dhe raste të raportuara në prokurori. Pra, janë dy gjëra që nuk shkojnë me këtë ligj.

Si njësi e jashtme ku ju veproni në bazë të këtij ligji me iniciativë ka raste dhe problematika, ndërsa njësitë përgjegjëse nga brenda që e kanë detyrim ligjor të raportojnë rastet e korrupsionit brenda agjencive shtetërore dhe private, kemi pothuajse zero raste.

Një problematikë tjetër me këtë ligj është edhe mosraportimi, të paktën edhe formalisht, si detyrim ligjor nga ana e këtyre agjencive. Për këtë unë mendoj se ka nevojë për ndërhyrje ligjore, që ne ta definojmë si detyrim ligjor raportimin pranë Inspektorit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive, sipas këtij ligjin, që të mos ngelet i vdekur nga pikëpamja e zbatimit të tij.

Unë e di ngarkesën e punës që ka institucioni juaj, pasi po punoni për organet e vetë, për të përfunduar dhe përmbyllur me sukses procesin e vetë me rreth 1000 zyrtarë të drejtësisë, i cili është në proces, po ashtu edhe për një numër të konsiderueshëm të zyrtarëve të policisë që do t’i nënshtrohen vetë. Ju inkurajoj për vazhdimin e punës siç keni bërë deri më sot. Nga ana e Komisionit dhe Kuvendit të Shqipërisë do të keni të gjithë mbështetjen që ju kërkon, jemi të hapur për ta çuar më tej punën e përbashkët për të luftuar korrupsionin në radhët e zyrtarëve të lartë, sepse unë jam i bindur që do ta fitojmë betejën me korrupsionin.

Edhe një herë faleminderit për paraqitjen në komision.

Falënderoj edhe relatorin, kolegun Fino, për materialin e plotë dhe shterues që paraqiti në komision.

Unë besoj se zoti Fino dhe këshilltarët e komisionit do t'i kenë në konsideratë ato që u thanë këtu, si nga diskutimet, por edhe nga përgjigjet e pyetjeve, për rezolutën që ne do të hartojmë për ta miratuar në mbledhjen tjetër.

Gjithashtu, dua t'i kërkoj edhe kryeinspektorit që në raportimet që do të bëjë në seancën plenare të mbajë në konsideratë ato që u diskutuan sot në Komisionin e Ligjeve, sepse kolegët e tjerë deputetë, por edhe opinioni publik kanë nevojë që ta njohin si duhet punën që ka bërë ky institucion, në mënyrë që të mos ngelet një punë brenda sallës së Komisionit të Ligjeve apo brenda mureve të institucionit që drejtoni. Puna juaj duhet t'i bëhet e njohur publikut.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Këtu e mbylлим mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës do të njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA